

## MARRËVESHJE PER KONSORCIUM

për realizimin e projektit për promovimin dhe zhvillimin e mësimi dual lidhur me aplikimin për skemën e granteve të financuar nga LuxDev në bashkëpunim me KIESA

### I. Palët nënshkruese

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

[Emri i Shkollës Profesionale Publike- \_\_\_\_\_], me seli në [Adresa - \_\_\_\_\_], e përfaqësuar nga [Emri, Mbiemri, Pozita - \_\_\_\_\_], në vijim të tekstit “**Shkolla**”; dhe

2. [Emri i Biznesit Privat - \_\_\_\_\_], me seli në [Adresa - \_\_\_\_\_], me numër biznesi [nr- \_\_\_\_\_], e përfaqësuar nga [Emri, Mbiemri, Pozita - \_\_\_\_\_], në vijim të tekstit “**Biznesi**”.

Të dyja palët së bashku në vijim do të quhen “Konsorciumi - \_\_\_\_\_”

### II. Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Shkollës dhe Biznesit privat për realizimin e programit të mësimi dual, që mundëson zhvillimin e pjesës praktike të arsimit profesional në ambientet e biznesit, në harmoni me kurrikulën përkatëse të arsimit profesional.

### III. Fushat e bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në këto fusha:

1. Zhvillimi i praktikës profesionale për nxënësit e Shkollës në ambientet e Biznesit;
2. Harmonizimi i kurrikulës me nevojat e tregut të punës dhe teknologjinë bashkëkohore;
3. Këshillimi profesional dhe trajnimi praktik nga ekspertët e Biznesit;
4. Promovimi i mësimi dual dhe nxitja e punësimit të rinjve të kualifikuar;
5. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për mësimin praktik (mjete pune, pajisje, siguri dhe higjienë në punë).

### IV. Detyrimet e Shkollës

Shkolla obligohet të:

- Përzgjedhë nxënësit që do të marrin pjesë në praktikë sipas kriterëve të dakorduara;
- Sigurojë mbikëqyrjen pedagogjike dhe koordinimin me mentorët e Biznesit;
- Harmonizojë orarin e praktikës me planin mësimor;
- Përcjellë përparimin dhe vlerësimin e nxënësve në bashkëpunim me Biznesin.

## **V. Detyrimet e Biznesit**

Biznesi obligohet të:

- Sigurojë kushte adekuate për zhvillimin e praktikës profesionale;
- Caktojë mentorë të kualifikuar për mbikëqyrjen e nxënësve;
- Njohë orët e punës praktike si pjesë e programit mësimor;
- Të sigurojë pajisjet, materialet dhe udhëzimet e nevojshme për zhvillimin e praktikës;
- Të respektojë standardet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë për nxënësit praktikantë;
- Jep vlerësim për performancën e nxënësve në fund të praktikës.

## **VI. Detyrimet e përbashkëta**

“**Sigurimi i nxënësve**” në sistemin e edukimit dual në Kosovë është i rregulluar ne baze te legjislacionit ne fuqi. Palët nënshkruese te kësaj marrëveshje janë te obliguara qe te bëjnë sigurimin e nxënësve dhe kjo çështje është objekt i marrëveshjes ndërmjet palëve.

## **VII. Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme për periudhën [\_\_\_\_], me mundësi rinovimi me pëlqimin e të dy palëve.

## **VII. Monitorimi dhe vlerësimi**

Zbatimi i marrëveshjes do të monitorohet nga një komision i përbashkët, i përbërë nga përfaqësues të Shkollës dhe Biznesit, i cili do të raportojë mbi ecurinë e projektit dhe do të propozojë përmirësime.

## **VIII. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve. Në rast të pamundësisë për marrëveshje, çështja do të dërgohet për zgjidhje në instancat kompetente ligjore të Republikës së Kosovës.

## **IX. Nënshkrimi**

Kjo marrëveshje u hartua në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën palë, dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Për Shkollën Profesionale Publike:**

Emri, Mbiemri:

\_\_\_\_\_  
Pozita:

\_\_\_\_\_  
Data: \_\_\_\_\_

**Për Biznesin Privat:**

Emri, Mbiemri:

\_\_\_\_\_  
Pozita:

\_\_\_\_\_  
Data: \_\_\_\_\_